

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUNDËSHEM  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

M. 10. 20 17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtarin Mustaf Tahiri dhe procesmbajtësen Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR] rr.” [REDAKTUAR]”, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH –së në Ferizaj PP. nr.2308-06/13 të dt. 07.05.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë publik, në praninë e prokurorit të shtetit, Visar Musa, të pandehurit , më dt. 06.06.2016 njëjtën morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri, [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rr.” [REDAKTUAR]”, i lindur më [REDAKTUAR], në fshatin [REDAKTUAR] komuna [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], ka të kryer shkollën e lartë, me profesion tregtar, pronarë i kompanisë “ [REDAKTUAR]”, i martuar, baba i katër fëmijëve, me nr.personal. [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 364 par. 1 nënpar. 1.3 të KPPK-së,

**LIROHET NGA AKUZA**

Sepse më datën 05.05.2011, në rrugën “Bajram dhe Gursel Sylejmani” në Ferizaj, saktësisht në ndërtesën kolektive të [REDAKTUAR] me anë të paraqitjes së rreme e për përfitim të kundërligjshëm pasuror për vete ka vënë në lajthim të dëmtuarin [REDAKTUAR] në atë mënyrë që i ka shitur lokalin afarist me autorizim të [REDAKTUAR] në sipërfaqe prej 48.38 metra katror në katin përdhese të evidentuar në fletëposedim 713 dhe 8240 Zyra Kadastrale Ferizaj në vlerë prej 60.000€ edhe pse më parë këtë lokal në marrëveshje me [REDAKTUAR] e kishte ndërruar me shtëpinë e saj dy katëshe me dy ari oborr dhe në kundërvlerë [REDAKTUAR] kishte marrë një banesë prej 65m2 dhe lokalin prej 50m2 dhe 5.000€, ku lokalin e njëjta e kishte shfrytëzuar dhe e shfrytëzon edhe më tutje,

Me këtë kishte për të kryer veprë penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] rruga [REDAKTUAR] afër mobilierisë “ [REDAKTUAR]” dhe depos së materialit ndërtimor “ [REDAKTUAR]” në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## Arsy etimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP nr.2308-6/13 të dt.07.05.2014 ka ngarkuar të pandehurin, [REDAKTUAR] nga Ferizaj për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt.01.10.2015, ku prokurori i shtetit Rafet Halimi ka lexuar aktin akuzues, dhe më pas në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit Visar Musa mbeti në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, dhe i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet një sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjyqtari individual pasi u bind se i pandehuri ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 të KPPK-së të akuzuarit i ofroi mundësin të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, I pandehuri [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale me të cilën është ngarkuar.

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke shtuar se i njëjti merret me biznes te ngjyrave dhe fasadave dhe se sa i përket lokalit afarist i cili gjendet te ndërtesa te "[REDAKTUAR]" atë lokal fillimisht e ka marrë në kompensim prej [REDAKTUAR] i cili është pronar i objektit dhe se aty ka kryer punë dhe si kompensim e ka marrë lokalin, të cilin lokal më vonë ja ka ofruar [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], i cili po ashtu merret me të njëjtën veprimtari të ngjyrave dhe me të njëjtin kemi bashkëpunuar dhe për shkak të borxhit që ka pas ndaj [REDAKTUAR] ja ka dhenë të njëjtin lokal si kompensim. Më vonë [REDAKTUAR], i për shkak të largësisë dhe mosinteresimit dhe duke e parë që në atë objekt nuk po investohet i ka thënë tani tani të akuzuarit që tja gjej ndonjë myshteri për tja shitur këtë lokal për çka [REDAKTUAR] edhe e kishte autorizuar tani të akuzuarin të cilin autorizim e kishte vërtetuar në Gjykatë. Të njëjtin lokal i akuzuari në cilësi të autorizuarit ja kishte shitur [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ku në momentin e shitjes të njëjtit i kam prezantuar gjithë dokumentacionin duke përfshirë kontratën e lidhur mes [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] si dhe dokumentacionin administrativ komunal me taksat e paguara e po ashtu edhe autorizimin që ma kishte dhënë [REDAKTUAR]. Të njëjtin lokal [REDAKTUAR] ja ka shitur në shumën prej 48.000€, të cilën shumë [REDAKTUAR] ma ka kompensuar duke marrë një sasi rrobave që i kishte sjellë nga Kanadaja për ti shitur, një veturë të tipit "Crysler" viti prodhimit 2007 si dhe shumën e parave në vlerë prej 7.000€ dhe pasi që ishim marrë vesh për çmimin dhe mënyrën e pagesës ja kam dorëzuar çelësin e lokalit i cili edhe ka hy në posedim, mirëpo diku pas një viti [REDAKTUAR] më tha se një grua me emrin [REDAKTUAR] është lajmëruar dhe me ka thënë se ky lokal është i imi. Ndërsa sa i përket [REDAKTUAR], i pandehuri ka deklaruar se para 4-5 viteve para se t'ia shes [REDAKTUAR] lokalin, ja ka shitur një banesë përkatësisht ka bërë ndërrimin e duke ja dhenë asaj banesën prej 65m2 dhe shumën e parave prej 7.000€ dhe nga ajo ka marrë një shtëpi me 1.5 ari oborr me dimensione prej 7 m x 7 m, e cila shtëpi gjendet prapa rr."Hasan Prishtina", për çka ne kemi bërë një kontratë tek avokati, mirëpo të njëjtën kontratë nuk e kemi vërtetuar në gjykatë pasi që e njëjta nuk ka qenë pronare. Më vonë deri sa [REDAKTUAR] e ka pas në posedim këtë lokal [REDAKTUAR] e ka thyer drynin e lokalit dhe ka hyrë në atë lokal dhe rastin e ka paraqit në polici dhe e di që për këtë është në procedurë gjyqësore për vërtetim pronësie.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Shih mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dt.23.05.2016

Gjykata për ta vërtetuar gjendjen faktike bëri administrimin e provave si ato të propozuara nga përfaqësuesi i akuzës –prokurori i shtetit edhe ato të propozuara nga mbrojtja e të pandehurit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se me dt.05.05.2011 ka lidhur kontratë për shitblerjen e palujtshmërisë së lokalit afarist i cili gjendet në rrugën e “Varoshit” të banesat te [REDAKTUAR]. Këtë kontratë e ka lidhur me I [REDAKTUAR] i cili mi ka prezantuar kontratën e nënshkruar në mes [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]. Këtë lokal jemi marr vesh për çmimin prej 60.000€, ku një pjesë të parave shumë prej 10.000€, veturën e tipit “Krajsler” dhe pjesa tjetër garderobë. Të njëjtën kontratë e kemi përpiluar tek avokati dhe të njëjtën e kemi vërtetuar në gjykatë. I njëjti ka deklaruar se këtë lokal e ka shfrytëzuar diku 5-6 muaj, ku pastaj lokalit i është thyer dryri nga [REDAKTUAR] duke i thënë se ky lokal është i imi dhe pas kësaj i ka larguar sendet që i ka pasur të vendosura aty dhe më vonë kam parë që [REDAKTUAR] i ka vendosur disa sende të saja aty dhe më vonë në gjykatë ka filluar procedura kontestimore dhe më tutje nuk e di se çka ka ndodhur. Gjykata e ka vlerësuar dhe analizuar dëshminë e të dëmtuarit të njëjtën e merr si të besuar pasi që e njëjta bazohet edhe në dëshmitë dhe provat tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Dëshmitari [REDAKTUAR], në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në vitin 2008 pasi që më vdiq burri unë isha e interesuar ta shesë shtëpinë dhe ta blejë një banesë. Për këtë kërkova nga fqiu im [REDAKTUAR] që të më gjen ndonjë myshteri që ta shesh shtëpinë dhe [REDAKTUAR] ma kishte gjetur [REDAKTUAR] ku i njëjti kishte ardhur për ta shikuar shtëpinë. Ne u pajtuam që ta bëjmë ndërrimin e shtëpisë e cila gjendet në rr.”Hasan Prishtina” me një banesë te rr.Varoshit te [REDAKTUAR]. Dëshmitarja me tutja ka theksuar se se bashku me fëmijët e saj kishte shkuar për ta shikuar banesën ku [REDAKTUAR] i kishte thënë fillimisht se i ka dy banesa njëren në katin e parë dhe tjetren në katin e tretë dhe pasi që i shikua të dy banesat se bashku me fëmijët vendosëm dhe u morëm vesh siq ka deklaruar dëshmitarja që shtëpinë ta ndërrojmë me një banesë të cilën na e ofroi [REDAKTUAR] dhe atë në katin e parë në madhësi prej 65m2 dhe për këtë u pajtuam edhe fëmijët, për të cilën kemi përpiluar marrëveshje me shkrim tek avokati [REDAKTUAR] të cilën e ka përpiluar djali i avokatit e të cilën kontratë nuk e kam lexuar por vetëm e kam nënshkruar. E njëjta ka deklaruar se në marrëveshje gojore kemi pasur që unë [REDAKTUAR] me ja dhënë shtëpinë dhe nga ai me e marrë një banesë, podrumin prej 40-48 m2 dhe 5000€ para të cilin podrum e kam shfrytëzuar si depo për dru të dimrit e po ashtu edhe katër familje tjera e kanë shfrytëzuar të njëjtin podrum si depo, mirëpo para tre –katër vite deri sa kam qenë në pushime në Durës dhe me tu kthyer unë i kamë parë drutë e mija dhe të fqinjëve të cilët kishin të larguara nga podrumi dhe ishin vendosur në korridor dhe për këtë rast kam lajmëruar policinë dhe tash rasti është në procedurë gjyqësore në gjykatë. Gjykata me kujdes të veçantë e ka analizuar dëshminë e kësaj dëshmitare duke i vlerësuar bashkërisht me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë dhe provave materiale të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor dhe gjykata dëshminë e kësaj dëshmitare e ka vlerësuar si jo të reale dhe objektive për më tepër përmban zbrastësi dhe mangësi e cila nuk është edhe në përputhje me provat tjera siq është ajo e dëshmitarit [REDAKTUAR], dëshmitarit [REDAKTUAR] dhe me kontratën e shitblerjes së palujtshmërisë dt.02.04.2008.

Gjykata ka dëgjuar edhe dëshmitarin [REDAKTUAR] i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në cilësi të avokatit në zyrën e tij a ka përpiluar kontratën e datës 02.04.2008 në mes të shitëses [REDAKTUAR] dhe blerësit [REDAKTUAR] dhe se në momentin e lidhjes së kësaj

kontrate kanë qenë prezent edhe dy fëmijët vajza dhe djali i shitëses [REDACTED] të cilët kanë qëndruar jashtë zyrës. Të dy palët shitësi dhe blerësi kanë pasur vullnet të plotë dhe se e kanë njoftuar se objekt i kësaj kontrate është ndërrimi-shitja e palujtshmërisë së një shtëpie me një banesë dhe se gjatë përpilimit të kësaj kontrate nuk është përmendur as ndonjë lokal e as ndonjë podrum përveç se ndërrimi i shtëpisë me banesë dhe se sipas parimeve të mija paraprakisht palëve gjithmonë ua lexojë dhe ua shpjegoj dhe i pyes se a pajtoheni, a është përfshirë tërë ajo që është në marrëveshje, mos keni ndonjë plotësim apo përmirësim të dispozitave të kontratës, dhe edhe në rastin konkret kam vepruar duke ja lexuar kontratën dhe duke ua tërhequr mos kanë ndonjë mos qartësi, vërejte në kontratë dhe palët e kanë nënshkruar me vullnet të plotë dhe pa vërejtje para nënshkrimit të kësaj kontrate e të cilët e kanë nënshkruar para meje dhe në prezencën time i është dhënë shuma prej 2.000€ ashtu siç është paraparë në nenin 3 të kësaj kontrate.

Dëshmitari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se si [REDACTED] i kishte thenë dëshmitarit që është e interesuar ta ndërroj shtëpinë e saj me ndonjë banesë, pasi që e njejtja jetonte në kushte të vështira dhe se si i kishte vënë në kontakt me [REDACTED] i cili edhe akuzuar edhe [REDACTED] ishin aritur marrëveshje për ndërrimin e shtëpisë se [REDACTED] me një banesë të të akuzuarit [REDACTED] në rrugën e "Varoshit" ku si kundërvlerë i akuzuari tja jepte edhe shumën prej 5000 apo 8000 nuk jam i sigurt. I njejtja ka deklaruar se në kohën kur është biseduar në lidhje me ndërrimin e shtëpisë me banesë mes [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk është përmendur asnjë lokal dhe se për këtë lokal ka dëgjuar se fundmi kur është ftuar nga gjykata sepse në kohën kur kemi shkuar para se të bëjnë ndërrimin kur kam shkuar për ta shikuar banesën e [REDACTED] nuk është përmendur kurrfar lokali dhe se përveq banesës nuk kanë shikuar asnjë lokal e asnjë podrum.<sup>2</sup>

Dëshmitari [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i njejtja merret me shitjen e ngrave dhe llaqeve, fasade etj dhe se sa i përket lokalit i cili gjendet në rr."Varoshit" ka njohuri ngase me të akuzuarin [REDACTED] kanë pasur bashkëpunim në biznes dhe pasi që me pare i kishte dhënë material ngjyra dhe në pamundësi të pagesës i njejtja i kishte ofruar një lokal i cili gjindej në rr."Varoshit" ndërtesa kolektive kati i pare 45 m2, i cili lokal ishte ishte në emër të [REDACTED]. Pas kësaj së bashku me [REDACTED] kemi shkuar tek pishina në zonën industriale kemi biseduar me [REDACTED] i cili më tha se lokali është i tij, mirpo për shkak se ka obligime ndaj [REDACTED] është pajtuar që ky lokal të bartet në emrin tim, pastaj së bashku me [REDACTED] dhe [REDACTED] kemi ardhur kemi përpiluar kontratën dhe të njejtën pastaj e kemi vërtetuar në gjykatë, e mëpastaj kam filluar procedurat për bartjen e këtij lokali në emrin tim ku kam bërë kërkesën në gjeodezi dhe kadastër për të cilat kam paguar taksat komunale. Pas dy viteve pas nënshkrimit të kësaj kontrate jemi penguar nga një banorë e banesës, ku [REDACTED] më kishte thenë se ja kishte dhënë qelësat për të lënë drutë dhe gjërat tjera. i njejtja ka vazhduar me tutje me dëshminë e tij ku ka deklaruar se i kishte dhënë autorizim [REDACTED] për ta shitur këtë lokal, të cilin autorizim e kishin vërtetuar në Gjykatë Komunale në Prizren dhe këtë lokal ka vendosur ta shesë pasi që nuk kishte dalur ashtu siq kishte menduar pasi që kishte menduar se aty do të bëhet një qendër tregtare dhe do të hapen shumë lokale dhe pasi që kjo nuk ndodhi lokalet tjera nuk u hapen dhe nuk filloi ndonjë aktivitet biznesor aty. [REDACTED] e ka shitur këtë lokal dhe mua ma ka kompensuar një pjesë në të holla, pjesën tjetër veturë disa makina paisje për ngjyra, ngjyra dhe praj asaj dite unë këtë lokal nuk e kam konsiderua si timin.

<sup>2</sup> Shih dëshminë e dëshmitarit [REDACTED] në procesverbalin e dt.16.02.2016.

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtyre dëshmitarëve [REDACTED] dhe [REDACTED], i ka vlerësuar bashkërisht, dhe vlerëson se këto dëshmi janë të sakta, reale dhe të cilat dëshmi janë përforcuar edhe përmes provave materiale<sup>3</sup>.

Gjykata po ashtu bëri prezantimin e provave të propozuara nga prokurori i shtetit dhe nga i akuzuari dhe atë: kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë e dt.05.05.2011, deklarata e dt.10.05.2011, autorizimi i dt.05.05.2011, dëftesa për pranimin e kërkesës për regjistrim e dt.12.07.2007, aktvendimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr.311/11 dt.22.03.2012, Ankesa kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj C.nr.311/11 i dt.22.03.2012, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit CA.nr.3531/2012 i dt.10.05.2013, padi për vërtetimin e pronësisë e paditëses [REDACTED] e dt.22.03.2012, propozim për ekzekutim të aktvendimit C.nr.311/11 dt.02.07.2012, procesverbali i gjykatës Themelore Ferizaj dt.07.08.2013, konkluzë mbi zbrazjen dhe dorëzimin e palujtshmërisë dt.30.07.2013, aktvendimi i Komunës së Ferizaj dt.28.06.2007, dëftesa e Gjykatës Komunale në Ferizaj dt.10.05.2011, fletëpagesa e Bankës së [REDACTED] e dt.12.07.2007 dhe 28.06.2007, aktvendimi mbi lejen ndërtimore e lëshuar nga Kuvendi Komunal në Ferizaj e dt.27.12.2004, kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë e dt.15.02.2005, kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë e dt.28.06.2007, kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë e dt.02.04.2008 në mes shitëses [REDACTED] dhe blerësi [REDACTED]

Gjykata nga vlerësimi dhe analizimi i dëshmimeve të dëshmitarëve dhe provave tjera të administruara në shqyrtimin gjyqësor veq e veq dhe në lidhshmërinë e tyre gjykata me asnjë provë nuk gjeti se është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykim se i pandehuri më datën 05.05.2011, në rrugën "Bajram dhe Gursel Sylejmani" në Ferizaj, saktësisht në ndërtesën kolektive të Kecës, me anë të paraqitjes së rreme e për përfitim të kundërligjshëm pasuror për vete ka vënë në lajthim të dëmtuarin [REDACTED] në atë mënyrë që i ka shitur lokalin afarist me autorizim të [REDACTED] në sipërfaqe prej 48.38 metra katror në katin përdhese të evidentuar në fletëposedim 713 dhe 8240 Zyra Kadastrale Ferizaj në vlerë prej 60.000€ edhe pse më parë këtë lokal në marrëveshje me [REDACTED] kishte ndërruar me shtëpinë e saj dy katëshe me dy ari oborr dhe në kundërvlerë [REDACTED] kishte marrë një banesë prej 65m<sup>2</sup> dhe lokalin prej 50m<sup>2</sup> dhe 5.000€, ku lokalin e njëjta e kishte shfrytëzuar dhe e shfrytëzoi edhe më tutje dhe se nuk u vërtetua se i pandehuri ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 261 par.2 të KPK-së.

Gjykata përmes administrimit të provave materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetoi se i akuzuari ja kishte shitur lokalin të dëmtuarit [REDACTED] përmes autorizimit të cilin ja kishte dhënë [REDACTED] e i cili autorizim ishte vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren VR.nr.3647/11 dt.06.05.2011, ku i pandehuri me këtë autorizim kishte lidhur kontratë shitblerjes me tani të dëmtuarin [REDACTED] për shitblerjen e palujtshmërisë. Gjykata ka vlerësuar edhe kontratën e shitblerjes së palujtshmërisë e lidhur me datë 02.04.2008 në mes të shitëses [REDACTED] dhe blerësit [REDACTED] dhe pas vlerësimit të saj gjykata vërtetoi se në bazë të nenit II të kësaj kontrate kontraktuesit janë dakorduar që shitësi t'ia shtet shtëpinë shitësja e saj dy katëshe në sipërfaqe prej 00.03.00ha në Ferizaj rr."Hasan Prishtina" ku blerësi ia jep banesën e cila gjendet në rr."Ahmet Kaçiku" pn, si dhe shumën prej 2.000€ ku është bërë pagesa, ndërsa shumën prej 3.000€ do t'ia jap ditën e përkthimit të përkthimit të palujtshmërisë. Gjykata duke analizuar dhe vlerësuar këtë vërtetoi se në kontratë të

<sup>3</sup> Shih provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

shitblerjes e cila është nënshkruar me vullnetin e palëve në asnjë dispozitë të saj nuk është cekur se shitësja [REDAKTUAR] si kompensim edhe lokalin afarist në sipërfaqe prej 48m2 i cili gjendet në ndërtesën kolektive të [REDAKTUAR] në katin përdhese të evidentuar në fletëposedim 713 dhe 8240 Zyra Kadastrale Ferizaj dhe se [REDAKTUAR] dhe tani i akuzuari nuk u vërtetua se më parë për këtë lokal kishin marrëveshje me [REDAKTUAR] për ndrimin e shtëpisë së saj dykatëshe me dy ari oborr dhe në kundërvlerë [REDAKTUAR] të merr Banesën prej 65m2 dhe lokalin prej 50m2 dhe 5.000€, pasi që në bazë të kontratës së shitblerjes u vërtetua fakti se shitësja [REDAKTUAR] me tani të akuzuarin e kishte ndruar shtëpinë e saj dy katëshe me 00.03.00ha oborr në Ferizaj rr. "Hasan Prishtina" me banesë e cila gjendet në rr. "Ahmet Kaçiku" pn, si dhe shumën prej 2.000€ ku është bërë pagesa, ndërsa shumën prej 3.000€ do tia jap ditën e përkthimit së përkthimit të palujtshmërisë.

Prandaj sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret me provat e propozuara dhe të administruara në shqyrtim gjyqësor nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet se i pandehuri nuk e ka vënë në lajthim të dëmtuarin [REDAKTUAR] por i njëjti lokalin i cili ka qenë i [REDAKTUAR] për të cilin [REDAKTUAR] i ka dhënë autorizim të akuzuarit e i cili autorizim është vërtetuar në Gjykatë, në bazë të këtij autorizimi edhe i dëmtuari e ka ditur se kontratën është duke e lidhur me të autorizuarin e [REDAKTUAR] e cila kontratë e shitblerjes është nënshkruar mes palëve me vullnet të plotë, andaj gjykata në kuptim të nen. 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK-së vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizi rruga [REDAKTUAR] afër mobilierisë " [REDAKTUAR] dhe depos së materialit ndërtimor "Lala" në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nen. 454 par.1. të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P.nr.520/14 të dt. 06.06.2016**

Procesmajtësja,  
Drita Ujupi

**Gjyqtari,**  
Mustaf Tahiri

**KËSHILLA JURIDIKE** – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

EXP.

06.06.2016

